

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK**

**Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/34;
Datë: 10.11.2020.**


Në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 21 paragrafi 21.1 dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika k) të Statutit të Komunës së Junikut, neni 3 paragrafi 3.4, nën paragrafi 3.4.3, neni 6, i Rregullores për Simbolet, Titujt e Nderit, Dekoratat, Medaljet, Mirënjohjet dhe Falënderimet në Komunën e Junikut, propozimit të Kryetarit të Komunës, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 30.10.2020 nxjerrë:

V E N D I M

- I. Me titullin "Nderi i Junikut" nderohet **z.Luan Kraniqi**, ish Kampion Evrope në pesha të rënda në kategorinë EBU dhe vendin e dytë në botë në pesha të rënda në kategorinë WBO.
- II. Titulli "Nderi i Junikut", është titull që u jepet personaliteteve të shquara të Komunës së Junikut që kanë dhënë kontribute të veçanta dhe tepër të rëndësishme, të cilët kanë lartësuar emrin e Junikut, që kanë një veprimtari të gjerë dhe të rëndësishme në dobi të qytetarëve, vlera të veçanta dhe shumë të njohura në rrafshin kombëtar, që janë personalitete të rëndësishme në fusha të veçanta të shoqërisë, shkencës, artit dhe sportit, që kanë formuar një figurë të pastër dhe që kanë cilësi të larta njerëzore.
- III. Komuna e Junikut ka nder dhe privilegj të ndaj këtë titull për personalitetin tuaj.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- Z.Luan Krasniqi,
- Kryetari i Komunës së Junikut,
- MPL,
- Arkiva.



Adresa:
Tel.: +386 (0) 49 760 297
<http://rks-gov.net/junik>